



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 08/2023
PËR MËNYRËN E KOMPENSIMIT PËRFSHIRË EDHE
LLOGARITJEN E KOMPENSIMIT PËR DËMTIMET E
SHUMËFISHTA¹

¹ Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 08/2023 për mënyrën e kompensimit përfshirë edhe llogaritjen e kompensimit për dëmtimet e shumëfishta është miratuar në Mbledhjen e 172-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 04/172, të datës 08.11.2023.

Qeveria e Republikës së Kosovës

Në mbështetje të Nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 10, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L -109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, dhe nenin 8, paragrafi 4, nën-paragrafi 4.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenin 19, paragrafi 6, nën-paragrafi 6.2 të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë,

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 08/2023 PËR MËNYRËN E KOMPENSIMIT PËRFSHIRË EDHE LLOGARITJEN E KOMPENSIMIT PËR DËMTIMET E SHUMËFISHTA

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i mënyrës së kompensimit përfshirë edhe procedurën e pranimit, trajtimit, shqyrtimit të kërkesave, llogaritjen dhe vendimmarrjen për kompensimin e viktimave të krimit dhe të vartësve të tyre.
2. Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të obligueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik që marrin pjesë në procesin e kompensimit të viktimave të krimit.

Neni 2

Të drejtat e viktimës

1. Viktima duhet të jetë e njoftuar në tërësi për të drejtat e saj, për procedurat dhe procesin e shqyrtimit lidhur me kufizimet dhe kriteret e nevojshme për aplikim në programin e kompensimit.
2. Ministria e Drejtësisë me qëllim të informimit të viktimave harton një udhëzues për procesin e aplikimit dhe shqyrtimit të kërkesave.

Neni 3

E drejta në kompensim

1. Llojet e veprave të dhunshme të cilat hyjnë në kategorinë e veprave të kompensueshme janë të gjitha veprat që rezultojnë në vdekjen e viktimës, lëndimin e rëndë trupor, dëmtimin e shëndetit fizik dhe mendor, përpos veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik, siç është e përcaktuar në nenin 6 të Ligjit.
2. Kushtet formale dhe materiale që duhet t'i plotësojë viktima për të pasur të drejtën në kompensim janë të përcaktuara në Ligj. Për situatat tejkufitare parashtruesit duhet të kenë

parasysh edhe kushtet e parapara me nenet 33, 34 dhe 35 të Ligjit si dhe nenet 19, 20 dhe 21 të këtij Udhëzimi Administrativ.

3.E kaluara kriminale e viktimës merret parasysh vetëm nëse viktima ka qenë e përfshirë në vepra penale aq të rënda sa kompensimi do të ishte në kundërshtim me kuptimin e drejtësisë apo rendit publik, apo dëmshpërblimi do të konsistonte në përdorim jo të drejtë të fondeve publike.

4.Komisioni do të merr parasysh edhe kontributin e viktimës në shkaktimin e dëmit apo në përkeqësimin e dëmit të shkaktuar gjatë veprës penale.

Neni 4 Përfituesit e kompensimit

1. Në bazë të Ligjit, të drejtë për të kërkuar kompensim nga shteti kanë:
 - 1.1.viktimat e veprave penale të kompensueshme sipas Ligjit;
 - 1.2.anëtarët e familjes dhe vartësit e viktimës;
 - 1.3.viktimat e rastit nëse plotësojnë kriteret e caktuara me dispozitat e ligjit.
2. Viktimat mund të kërkojnë kompensim për lëndimet, dëmtimet dhe shpenzimet si në vijim:
 - 2.1.lëndimin fizik apo dëmtimin e shëndetit;
 - 2.2. dëmtimin e shëndetit mendor;
 - 2.3. kompensimin për vuajtjen psikike;
 - 2.4. humbjen e së drejtës në mbajtje nëse ka mbajtës dhe kontribues në mbajtjen e tyre;
 - 2.5.dëmtimin apo shkatërrimin e pajisjeve mjekësore;
3. Vartësit mund të kërkojnë kompensim për shpenzimet si në vijim:
 - 3.1. kompensimin për vuajtje psikike për humbjen e anëtarit të familjes;
 - 3.2. humbjen e të drejtës në mbajtje në rast të vdekjes së viktimës;
 - 3.3.shpenzimet mjekësore dhe hospitalizimit;
 - 3.4. shpenzimet e varrimit;
 - 3.5.kompensimin në situata të paraqitura sipas nenit 20, paragrafi 2 të Ligjit.

Neni 5 Kompensimi për lëndimin fizik apo dëmtim të shëndetit

1. Kërkesa nga parashtruesit e kërkesës për kompensim për lëndim fizik apo dëmtim të shëndetit bëhet në pajtim me nenin 11 të Ligjit.
2. Komisioni përcakton shkallën e dhembjes dhe lartësitë e kompensimit në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës për kompensimin në pajtim me nenin 11 paragrafit 3 të Ligjit.
3. Lëndimi apo dëmtimi sipas nenit 11 të Ligjit duhet të jetë i natyrës së rëndë në pajtim me nenin 6, paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit.
4. Për të përmbushur kushtet për kompensim sipas nenit 11, nën paragrafit 3.1 të Ligjit, pasoja e shkaktuar duhet të jetë në përputhje me përkufizimin e përcaktuar në nenin 186, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3. të Kodit Penal të Kosovës, me kusht që lëndimet, dëmtimet apo sëmundja të kenë kohëzgjatje mbi 6 javë.
5. Për të përmbushur kushtet për kompensim sipas nenit 11, nën paragrafit 3.2 të Ligjit, pasoja e shkaktuar duhet të jetë në përputhje me përkufizimin e përcaktuar në nenin 186, paragrafi 2, nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me kusht që lëndimet, dëmtimet apo sëmundja të jenë me pasojë afatgjate apo të përhershme.
6. Komisioni përcakton edhe lartësinë e kompensimit për shpenzimet e realizuara për hospitalizim, medikamente dhe shërbime tjera përcjellëse të domosdoshme për trajtimin e viktimave për lëndimet sipas këtij neni. Kompensimi do të bëhet vetëm për shpenzimet e dokumentuara me kupon fiskal nga parashtruesi i kërkesës, të cilat nuk janë ofruar falas nga institucioni shëndetësor.
7. Kompensimi sipas këtij neni nuk përfshinë terapitë rehabilituese në banjat termike.
8. Të gjitha shërbimet duhet të jenë të rekomanduara dhe ofruara nga specialistët mjekësor të licencuar të fushës përkatëse.
9. Vartësit e viktimave të cilët kanë bartur shpenzimet e hospitalizimit, medikamenteve dhe shërbimeve tjera për trajtimin e viktimave kanë të drejtën në kompensim në bazë të dokumentacionit të paraqitur sipas kriterëve të mësipërme.
10. Komisioni, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 11 të Ligjit, me votë unanime, ka diskrecion që të tejkalojë maksimumin e paraparë të kompensimit sipas paragrafit 4 të nenit 11 të Ligjit, nëse e gjen të arsyeshme se shpenzimet e realizuara për trajtimin e lëndimit të rëndë apo dëmtimit të shëndetit fizik kanë qenë të domosdoshme.
11. Kompensimi për lëndimin fizik apo dëmtimin e shëndetit mund të realizohet përmes kërkesës për kompensim të menjëhershëm dhe të rregullt. Në kuadër të kompensimit të menjëhershëm viktimat mund të kompensohen vetëm për shpenzimet e hospitalizimit, medikamenteve dhe shërbimeve tjera përcjellëse për trajtimin e këtij lëndimi apo dëmtimi të shëndetit.

Neni 6

Kompensimi për dëmtimin e shëndetit mendor

1. Kompensimi për dëmtimin e shëndetit mendor sipas nenit 12, i referohet dëmtimi të shëndetit

mendor nga neni 6, paragrafi 1.4 të Ligjit.

2. Për të qenë i kompensueshëm dëmtimi i shëndetit mendor duhet të:

2.1. jetë në atë shkallë që të ndikojë në aktivitetet e zakonshme të viktimës;

2.2. të ndikojë në gjendjen psikologjike për një periudhë të zgjatur kohore;

2.3. viktima të ketë nevojë për trajtim të vazhdueshëm;

2.4. të mos jetë paaftësi, dëmtim apo ç'rregullim i mëparshëm, i cili nuk është pasojë direkte e veprës së dhunshme.

3. Kompensimi në bazë të nenit 12, paragrafi 3.1. dhe 3.3 i Ligjit jepet vetëm për shpenzimet e dokumentuara me kupon fiskal nga parashtruesi i kërkesës, të cilat nuk janë ofruar falas nga institucioni shëndetësor.

4. Kompensimi në bazë të nenit 12, paragrafi 3.2, jepet për shpenzimet e projektuara për shërbimet e parapara për sanimin e gjendjes së krijuar, nëse konstatohet nga specialistët e fushës që viktima ka nevojë për trajtim të mëtutjeshëm sipas protokolleve. Në kërkesë të viktimës, Komisioni sipas vlerësimit të të gjitha rrethanave, mund të shqyrtojë edhe një kërkesë për shpenzimet e projektuara sipas paragrafit 5 të nenit 12 të Ligjit.

5. Në rastet e kompensimit të shpenzimeve të projektuara, Komisioni mund të bazohet në lartësinë e shpenzimeve të realizuara sipas paragrafit 3.1 të nenit 12 të Ligjit.

6. Komisioni mund të kërkojë nga institucionet përkatëse kontraktimin e shërbimeve të trajtimit të dëmtimit të shëndetit mendor. Në këtë rast shpenzimet e projektuara sipas paragrafit 3.2 të nenit 12 të Ligjit, i paguhen drejtpërdrejt institucionit të kontraktuar.

7. Kompensimi sipas nenit 11 të Ligjit nuk e përjashton viktimën të kërkojë kompensim sipas nenit 12 të Ligjit.

8. Për paraqitjen e kërkesës sipas Ligjit parashtruesi duhet të:

8.1. të prezantojë diagnozën dhe rekomandimin e mjekut specialist të licencuar dhe faturat përkatëse për trajtimin mjekësor dhe medikamentet e nevojshme për sanimin e gjendjes.

8.2. të gjitha shërbimet duhet të jenë të rekomanduara dhe ofruara nga specialistet mjekësor të licencuar të fushës përkatëse.

9. Kompensimi për shpenzimet për dëmtimin e shëndetit mendor mund të realizohet përmes kërkesës për kompensim të menjëhershëm ose kërkesës për kompensim të rregullt. Në të dyja rastet kërkohet dokumentim i shpenzimeve në pajtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 7

Kompensimi për vuajtje psikike

1. Në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Ligjit, viktimat e kategorive të parapara konsiderohet se kanë plotësuar kriteret për kualifikim për kompensim pa pasur nevojë të prezantojnë dëshmi.

2.Për kompensimin e viktimave nga kjo kategori duhet që:

2.1.rasti të jetë i trajtuar në procedurën penale; dhe

2.2.viktima jo domosdoshmërisht duhet të ketë pësuar ndonjë lëndim apo dëmtim të rëndë të shëndetit fizik.

3.Kompensimi për vuajtjen psikike mund të realizohet vetëm përmes kërkesës për kompensim të rregullt.

Neni 8

Kompensimi për vuajtje psikike për humbjen e anëtarit të familjes

1. Kompensimi nga kjo kategori rrjedh në bazë të dispozitave të nenit 14 të Ligjit.

2. Anëtarët e familjes që mund të marrin kompensim në kuadër të kësaj kategorie janë:

2.1. prindi, prindi adoptues;

2.2. fëmija, fëmija e adoptuar;

2.3. vëllau ose motra;

2.4. bashkëshorti ose bashkëshortja;

2.5. i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtin shtëpi;

2.6. personi me të cilin viktima ka jetuar në bashkësi jashtëmartesore.

3.Për të dëshmuar marrëdhënien nga paragrafi 2, parashtruesi i kërkesës duhet të prezantoj certifikatën e bashkësisë familjare ose çfarëdo dokumenti i cili dëshmon këtë lidhje.

4. Kompensimi për këtë kategori bëhet në pajtim me nenin 6 të këtij Udhëzimi. Shuma totale e kompensimit nuk mund të tejkalojë shumën prej tre (3) mijë euro në total për të gjithë anëtarët e familjes.

5. Për paraqitjen e kërkesës parashtruesi duhet të:

5.1.të prezantojë diagnozën dhe rekomandimin e mjekut specialist të licencuar dhe

5.2.faturat përkatëse për trajtimin mjekësor dhe medikamentet e nevojshme për sanimin e gjendjes.

6.Të gjitha shërbimet duhet të jenë të rekomanduara dhe ofruara nga specialistët mjekësor të licencuar të fushës përkatëse.

7.Kompensimi në bazë të këtij neni jepet vetëm për shpenzimet e dokumentuara me kupon fiskal nga parashtruesi i kërkesës, të cilat nuk janë ofruar falas nga institucioni shëndetësor.

8.Kompensimi për vuajtjen psikike për humbjen e anëtarit të familjes mund të realizohet vetëm përmes kërkesës për kompensim të rregullt.

Neni 9

Kompensimi për humbjen e të drejtës në mbajtje

1. Kompensimi për humbjen e të drejtës në mbajtje mund të jepet në rastet kur i ndjeri ka qenë kontribues në mbajtjen e parashtruesit/ve të kërkesës për kompensim sipas këtij neni. Kompensimi sipas këtij paragrafi nuk do të kalojë shumën maksimale prej tremijë (3000) euro.

2. Viktima e cila ka vartës dhe është kontribues në mbajtjen e vartësve, ka të drejtë në emër të vartësve të parashtrorë kërkesë për kompensim sipas nenit 15, paragrafi 2, me kusht që viktima të mos ketë pranuar kompensim sipas nenit 11 paragrafi 3 i Ligjit. Nëse viktima ka dorëzuar kërkesën për kompensim sipas nenit 11 paragrafi 3 të Ligjit dhe njëkohësisht edhe sipas nenit 15 paragrafi 2 të Ligjit, Komisioni vlerëson bazën më të arsyeshme për kompensim. Kompensimi sipas këtij paragrafi nuk do të kalojë shumën maksimale prej tremijë (3000) euro.

3. Për të realizuar të drejtën në kompensim sipas këtij neni, viktima, respektivisht vartësit duhet të dokumentojnë punësimin apo çfarëdo kontributi tjetër financiar në mbajtjen e vartësve, si dhe gjendjen financiare të vartësve.

4. Nëse më shumë se një vartës ka qenë në varshmëri financiare nga viktima lartësia e kompensimit në mënyrë kumulative për vartësit nuk do të tejkalojë totalin e paraparë me Ligj.

5. Kompensimi për humbjen e së drejtës në mbajtje mund të realizohet vetëm përmes kërkesës për kompensim të rregullt.

Neni 10

Kompensimi për shpenzimet e varrimit

1. Kompensimi për shpenzimet e varrimit paguhet në shumën fikse prej njëmijë (1,000) euro pa pasur nevojë të dokumentohen shpenzimet. Parashtruesi i kërkesës duhet të posedojë autorizimin e anëtarëve të tjerë të familjes, për paraqitjen e kërkesës sipas nenit 28, paragrafi 4.2 të Ligjit dhe pranimin e këtij kompensimi sipas nenit 16, paragrafi 2 të Ligjit. Autorizimi duhet të specifikojë nëse jepet vetëm për parashtrim të kërkesës apo edhe për pranimin e kompensimit.

2. Shpenzimet për transportin e kufomës nga një shtet tjetër në Republikën e Kosovës janë shpenzime të paguara të cilat mund të kërkohen mbi shumën e paraparë me nenin 16, paragrafi 1 të Ligjit. Ky kompensim mbulon situatat kur viktima për shkak të lëndimit si pasojë e veprës penale të kompensueshme është dërguar për trajtim jashtë vendit.

3. Kompensimi sipas paragrafit 2 i këtij neni nuk mbulon shpenzimet e transportimit të viktimës për trajtim në vendin tjetër apo shpenzimet e përcjellësve të viktimës. Parashtruesi i kërkesës duhet të dokumentojë me prova të besueshme që shpenzimet nga ky nen janë bartur nga vet ai/ajo. Të drejtë të kompensimit kanë anëtarët e familjes së viktimës së ndjerë, shtetas i Republikës së Kosovës.

4. Kompensimi për shpenzimet e varrimit të realizohet përmes kërkesës për kompensim të menjëhershëm ose kërkesës për kompensim të rregullt.

Neni 11

Kompensimi për dëmet për shkatërrimin e pajisjeve mjekësore

1. Kompensimi sipas këtij neni mund të jepet vetëm në rast të dëmtimit të pajisjeve të domosdoshme për shëndetin apo për cilësinë e jetës së viktimës.
2. Për qëllime të këtij neni, shprehja “cilësi e jetës” nënkupton standardin e shëndetit, dhe mirëqenies së individit.
3. Pajisjet nga paragrafi 1 i këtij neni përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - 3.1. pajisje të dëgjimit;
 - 3.2. karroca;
 - 3.3. syzet dioptrike;
 - 3.4. proteza ortopedike;
 - 3.5. proteza dentale;
 - 3.6. pajisje tjera të cilat Komisioni i konsideron të domosdoshme.
4. Parashtruesi, duhet të sigurojë kuponin fiskal për pagesën e shpenzimeve për riparimin apo blerjen e pajisjes së re të dëmtuar si rezultat i veprës penale. Kompensimi për pajisje do të bëhet në bazë të çmimit të arsyeshëm për pajisjen e dëmtuar.
5. Kompensimi për shpenzimet e dëmit të këtij lloji të kompensimit mund të realizohet përmes kërkesës për kompensim të menjëhershëm ose kërkesës për kompensim të rregullt.

Neni 12

Kompensimi i viktimës nga burime tjera dhe raporti me kompensimin sipas Ligjit

1. Viktimat dhe vartësit e tyre nuk mund të marrin kompensim të dyfishtë për të njëjtin dëm.
2. Me rastin e kompensimit të viktimës do të merren parasysh kompensimet tjera në pajtim me nenin 19 të Ligjit.
3. Në rastet kur Komisioni merr vendim për kompensim, gjykata kompetente do të njoftohet me vendimin e Komisionit dhe transferimin e kërkesës sipas dispozitave të nenit 40 të Ligjit.
4. Në njoftimin e Komisionit drejtuar Gjykatës, kërkohet që me rastin e vlerësimit të lartësisë së kompensimit të sigurohet që pjesa e kompensimit të urdhëruar ndaj të pandehurit të ndahet nga pjesa që do t'i kompensohet viktimës, duke bërë derdhjen e atyre mjeteve në Buxhetin e Kosovës dhe duke e njoftuar për këtë Komisionin.
5. Në çdo rast kur përfituesi i kompensimit realizon kompensimin nga çfarëdo burimi për të

njëtin dëm të kompensuar nga shteti, përfituesi ka për obligim të veprojë në pajtim me dispozitat e Nenit 41 paragrafi 2 i Ligjit.

Neni 13 **Kërkesa për kompensim**

1. Formularët e kërkesës për kompensim hartohen nga Ministria e Drejtësisë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Drejtësisë dhe udhëzimet tjera të nevojshme për të gjitha situatat vendore dhe tejkufitare.

2. Formularët dhe dokumentet mbështetëse të dorëzuara në Ministrinë e Drejtësisë janë konfidenciale dhe duhet të trajtohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 14 **Kërkesa për kompensimin e menjëhershëm**

1. Kërkesën për kompensim të menjëhershëm mund ta paraqesin vetëm parashtruesit e paraparë me nenin 8, paragrafi 1 të Ligjit dhe atë vetëm nëse janë plotësuar kushtet sipas paragrafit 3 të njëtin nen të Ligjit.

2. Kompensimi i menjëhershëm mund të jepet për:

2.1. Shpenzimet e varrimit;

2.2. Në rast të lëndimit apo dëmtimit të rëndë fizik, shpenzimet e paguara për hospitalizim, medikamente dhe shërbime tjera përcjellëse të domosdoshme për trajtimin e viktimës në pajtim me nenin 11, paragrafi 4 i Ligjit.

3. Në rast të dëmtimit të shëndetit mendor:

3.1. shpenzimet e paguara për trajtimin e viktimës sipas nenit 12, nën paragrafit 3.1 të Ligjit;

3.2. shpenzimet e hospitalizimit, medikamenteve apo shërbimeve tjera përcjellëse sipas nenit 12, nën paragrafit 3.3 të Ligjit.;

3.3. shpenzimet e paguara për blerjen apo riparimin e pajisjeve mjekësore të domosdoshme për shëndetin e viktimës, sipas nenit 17 të Ligjit.

4. Shpenzimet tjera të arsyeshme që mund të kompensohen me kërkesën për kompensim të menjëhershëm në bazë nenit 8, paragrafi 2.2.2 të Ligjit mund të jenë si në vijim:

4.1. shpenzimet e zhvendosjes në një vendbanim tjetër;

4.2. shpenzimet e strehimit të përkohshëm menjëherë pas veprës;

4.3. shpenzimet për nevojat bazike;

4.4. kompensime të tjera të cilat Komisioni i vlerëson të domosdoshme dhe të arsyeshme.

5. Me përjashtim të shpenzimeve të varrimit, për të gjitha kërkesat tjera për kompensim të menjëhershëm, shpenzimet duhet të jenë të dokumentuara me kupon fiskal.

6. Komisioni cakton lartësinë e kompensimit të menjëhershëm varësisht nga lloji i kompensimit të kërkuar sipas këtij neni. Kompensimi i menjëhershëm nuk mund të tejkalojë shumën e përgjithshme prej tremijë (3,000) euro. Për pjesën e kompensimit të porealizuar, viktimat mund të paraqesin kërkesë për kompensim të rregullt sipas Ligjit.

7. Komisioni ka diskrecion sa i përket lartësisë dhe arsyeshmërisë së kompensimit të shpenzimeve të arsyeshme nga paragrafi 3 i këtij neni.

Neni 15

Kërkesa për kompensimin e rregullt

1. Për kërkesën për kompensim të rregullt duhet të bashkëngjitet vendimi i plotfuqishëm i gjykatës në çështjen penale dhe dokumentacioni tjetër përcjellës i paraparë me Ligj dhe këtë Udhëzim Administrativ.

2. Për kërkesat që fillimisht janë pranuar në kuadër të kërkesës për kompensim të menjëhershëm, kompensimi jepet për pjesën tjetër të pa kompensuar dhe për kategoritë tjera për të cilat viktimat nuk është kompensuar.

3. Kërkesa për kompensim të rregullt mund të paraqitet për llojet e veprave të dhunshme të cilat hyjnë në kategorinë e veprave të kompensueshme që rezultojnë në vdekjen e viktimës, lëndimin e rëndë trupor, dëmtimin e shëndetit fizik dhe mendor, siç është e përcaktuar në nenin 6 të Ligjit.

4. Në pajtim me nenin 28, paragrafi 3 të Ligjit, kërkesës së parashtruar për situatat nga paragrafi 5 i nenit 9 të Ligjit, duhet t'i bashkëngjitet vendimi i plotfuqishëm apo ndonjë dokument tjetër zyrtar i cili dëshmon situatat e parapara me atë paragraf.

Neni 16

Plotësimi dhe dorëzimi i kërkesës për kompensim

1. Parashtruesi i kërkesës duhet të plotësojë formularin për të parashtruar kërkesën për kompensim.

2. Për dorëzimin e kërkesës për kompensim parashtruesit duhet të kenë parasysh afatet e parapara me nenin 29 të Ligjit.

3. Kërkesa e plotësuar së bashku me dokumentacionin përkatës dorëzohet në adresë të Ministrisë së Drejtësisë adresuar Divizionit për mbështetje Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit në njërin nga mënyrat më poshtë:

3.1. drejtpërdrejtë;

3.2. me postë;

3.3. me postë elektronike (email) në adresën e Komisionit.

4. Viktima, respektivisht vartësit mund të autorizojnë me shkrim personin tjetër që të plotësojë dhe të dorëzojë kërkesën në Ministrinë e Drejtësisë. Kërkesës i bashkëngjitet kopja e autorizimit. Autorizimi duhet të specifikojë nëse jepet vetëm për parashtrim të kërkesës apo edhe për pranimin e kompensimit.

5. Kërkesa e dorëzuar në cilëndo formë sipas këtij neni duhet gjithësesi të jetë e nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës.

6. Parashtruesi i kërkesës, garanton përmes nënshkrimit, vërtetësinë e të dhënave dhe dëshmive të paraqitura në aplikacion.

7. Parashtruesi i kërkesës jep pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin në fuqi .

8. Parashtruesi i kërkesës jep pëlqimin në klauzolën për transferimin e kërkesës ndaj kryesit nga parashtruesi në Qeverinë e Republikës së Kosovës deri në lartësinë e kompensimit të dhënë.

Neni 17

Dokumentet që duhet bashkëngjitur kërkesës për kompensim

1. Sipas nenit 28 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës ka obligim të bashkëngjis dokumente shitesë varësisht nga lloji dhe kategoria e kompensimit.

2. Në rast të pamundësisë së sigurimit të dokumenteve zyrtare, Komisioni në pajtim me nenin 32 të Ligjit mund të kërkojë nga autoritetet relevante qasje në të dhënat mbi rrethanat dhe faktet e rëndësishme për vendimmarrje.

3. Përveç formularit dhe dokumenteve të kërkuara sipas Ligjit, parashtruesi mund të bashkëngjitet çdo dokument që e konsideron relevant në mbështetje të kërkesës.

Neni 18

Standardi i vlerësimit

Komisioni vlerëson kërkesën duke përdorur standardin e vlerësimit të arsyeshëm. Informatat e prezantuara duhet të bindin një vëzhgues objektiv për vërtetësinë e informatave apo fakteve të kërkuara. Komisioni vlerëson arsyeshmërinë në varësi të rrethanave të rastit.

Neni 19

Kompensimi i viktimave të huaja

1. Shtetasit e huaj që janë viktimë e krimeve të dhunshme të kompensueshme sipas Ligjit mund të paraqesin kërkesën për kompensim përmes autoriteteve të tyre vendore.

2. Përjashtim nga paragrafi i mësipërm janë rastet kur plotësohen kushtet për qasje të menjëhershme në kompensim sipas dispozitave të nenit 9 të Ligjit me ç'rast kërkesa nga viktimat e huaja, e cila vazhdon të gjendet në Kosovë, mund të dorëzohet në të njëjtën procedurë

sikurse për viktimat vendore.

Neni 20

Komunikimi mes autoriteteve në situatat tejkufitare vendore

1. Në rastet kur kërkesa për kompensim paraqitet nga viktimat apo autoriteti i huaj, Ministria e Drejtësisë do të përcjellë brenda 7 dite kërkesën tek Komisioni për shqyrtim.
2. Komunikimi mes autoriteteve do të bëhet përmes formularit standard për komunikim ndërkombëtar të miratuar nga Ministria e Drejtësisë sipas dispozitave të nenit 34 paragrafi 2 të Ligjit.
3. Përveç formularit zyrtar për komunikim mes autoriteteve sipas paragrafit të mësipërm, autoritetet e huaja duhet të bashkëngjisin edhe formularin e kërkesës sipas dispozitave të nenit 27 paragrafi 7 të Ligjit si dhe të gjitha dokumentacionet tjera të nevojshme në mbështetje të kërkesës në pajtim me Nenin 28 të Ligjit.
4. Dokumentet e dorëzuara nga autoritetet e huaja të cilat dorëzohen në gjuhën angleze, sipas nevojës, do të përkthehen në gjuhët zyrtare në Kosovë për anëtarët e Komisionit. Shpenzimet e përkthimit mbulohen nga Ministria e Drejtësisë.
5. Në rast të nevojës për seancë dëgjimore sipas dispozitave të nenit 34 paragrafi 7 të Ligjit, Ministria e Drejtësisë do të lehtësojë këtë seancë sa më parë të jetë e mundur duke u koordinuar me autoritetin e huaj për të siguruar, sipas nevojës, përkthim për anëtarin/ët e Komisionit.
6. Pas marrjes së vendimit nga Komisioni, Ministria e Drejtësisë do të sigurohet që vendimi të përkthehet, sipas nevojës, në gjuhën përkatëse të pranueshme sipas ligjeve të atij shteti.
7. Vendimi duhet t'i dërgohet autoritetit të huaj jo më vonë se 60 ditë nga marrja e vendimit nga Komisioni.

Neni 21

Komunikimi mes autoriteteve në situatat tejkufitare të huaja

1. Në rastet kur shtetasi i Republikës së Kosovës ka rënë viktimë e ndonjë veprë penale të kompensueshme sipas ligjeve të atij shteti, dhe e njëjta nuk ka pasur mundësinë të paraqes kërkesën për kompensim direkt në at shtet, viktimat mund të paraqes kërkesën për kompensim përmes Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar mbështetje në dorëzim të kërkesës tek autoritetet përkatëse të atij shteti.
2. Ministria e Drejtësisë brenda 60 ditësh do të sigurojë informatat e nevojshme nëse kompensimi i shtetasit të Republikës së Kosovës është i mundur dhe i pranueshëm sipas ligjeve të shtetit ku vepra është kryer.
3. Nëse kompensimi nuk është i mundur sipas ligjit të atij shteti, parashtruesi i kërkesës do të njoftohet brenda 30 ditë nga pranimi i informatës. Viktimat njoftohet poashtu se në pajtim me nenin 7 nën paragrafin 1.2 të Ligjit, ka të drejtë që kërkesën ta paraqes direkt në Programin për kompensim pranë Komisionit.

4. Në rast se parashtrimi i kërkesës për kompensim është i mundur në shtetin ku është kryer vepra penale, Ministria e Drejtësisë sa më parë të jetë e mundur do të kontaktojë me autoritetet e huaja përkatëse.

5. Ministria e Drejtësisë përmes zyrës përkatëse për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, mban komunikimin me autoritetet e huaja.

6. Ministria e Drejtësisë do të sigurohet që kërkesa të dorëzohet në formularin dhe gjuhën e pranueshme sipas ligjeve të shtetit të huaj.

7. Zyra përgjegjëse për komunikim nga Ministria e Drejtësisë, sipas paragrafit 5 të këtij neni do ta mbajë në vazhdimësi të informuar Komisionin për çfarëdo kërkesë dhe komunikimi me autoritetet e huaja.

8. Ministria e Drejtësisë do të bart shpenzimet për përkthimin e dokumenteve në gjuhën përkatëse.

9. Në rast të kërkesës së autoriteteve të huaja për seancë dëgjimore sipas nenit 35 paragrafit 6 të Ligjit, Ministria e Drejtësisë do të kujdeset për aranzhimet rreth realizimit të seancës dhe përkthimit.

10. Ministria e Drejtësisë sa më parë të jetë e mundur do të njoftojë viktimën për çfarëdo vendimi të marrë nga autoritetet e huaja të komunikuar Ministrisë së Drejtësisë.

11. Ministria e Drejtësisë, do të sigurohet që në baza periodike, në varësi të afateve të dhëna sipas ligjeve dhe rregullave të shteteve përkatëse të kontaktojë autoritetet e atij shteti për të kërkuar informacion mbi statusin e kërkesës së parashtruar.

Neni 22

Fshehtësia dhe mbrojtja e të dhënave personale

1. Regjistrimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i të dhënave personale të këtyre personave bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi.

2. Njësia do të krijojë një bazë të të dhënave për të gjitha kërkesat e parashtruara dhe vendimet përkatëse.

3. Të dhënat e përfshira në kërkesën për kompensim mund të përdoren vetëm për qëllim të ushtrimit të së drejtës për kompensim financiar në përputhje me Ligjin dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

Neni 23

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzim Administrativ (QRK) nr. 01/2017 për mënyrën e kompensimit përfshirë edhe llogaritjen e kompensimit për dëmtimet e shumëfishta.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Datë: 30 nëntor 2023